

Pasurimi dhe pastrimi i gjuhës

Cështjet:

1. Pasurimi gjuhës
2. Burimet e pasurimit
3. Pastrimi gjuhës
4. Huazimet dhe fjalët ndërkombëtare
5. Qëndrimi ndaj fjalëve me burim të huaj

Pasurimi gjuhës.

Një nga shfaqet më të rëndësishme të zhvillimit të gjuhës standarde është pasurimi i saj me fjalë të reja dhe zgjerimi i rrethit të kuptimit të fjalëve ekzistuese. Për të përmbushur kërkesat e tyre për fjalë e terma, që shqipja nuk i ka pasur më parë, e për të plotësuar të gjitha nevojat kulturore, gjuhës letrare shqipe i është dashur të shtojë vazhdimisht mjetet e saj shprehëse, fjalët dhe kuptimet e reja.

Pasurimi i gjuhës është proces ligjësor objektiv, në të cilin marrin pjesë e veprojnë çdo ditë njerëz të thjeshtë e specialistë, shkrimtarë e artistë etj. Të gjithë këta, gjatë punës në sektorët dhe me mjeshtritë përkatëse, sa më shumë i zhvillojnë ato, aq më tepër kanë nevojë për emërtime të reja të prodhimit, për fjalë, shprehje a mënyra të thëni që u përgjigjen më mire, që japin më me përpikmëri nocionet idetë, që shprehin më me forcë jetën e botën shpirtërore të njeriut.

Kjo veprimtari e gjerë gjuhëkrijuese është ndjekur e studiuar me kujdes nga gjuhësia shqiptare. Ky pasurim i shqipes ka gjetur pasqyrim më të mirë në veprat “*Fjalor i gjuhës shqipe*” (1980) 40000 fjalë dhe në “*Fjalor i shqipes së sotme*” (1984) me rreth 34000 fjalë (ribotuar me plotësime më 2002), Fjalor i gjuhës shqipe (2006) me 41000 fjalë në të cilët jepet një pamje e thesarit të fjalëve të shqipes. Këta fjalorë, bashkë me fjalë të ditura e të fiksuara më parë në fjalorët pararendës, hodhën në qarkullim për herë të parë një sasi të madhe fjalësh të panjohura ose pak të njohura, të mbledhura nga goja e popullit ose të vjela nga burime të shkruara.

2. Burimet e pasurimit të gjuhës shqipe

a. Burimi kryesor i pasurimit të shqipes me fjalë është **formimi i fjalëve të reja me brumin e vetë shqipes dhe sipas modeleve prodhimore të sistemit fjalëformues të saj ose nëpërmjet shqipërimit të pjesëve përbërëse të fjalëve të huaja**. Sot numri i fjalëve të reja të formuara me rrugët e mësipërme është i madh e në të gjitha sferat e veprimtarisë së shqiptarëve. Të tilla, janë, p.sh. *domosdoshmëri*, *gadishmëri*, *qëndrueshmëri*, *mbingarkoj*, *përuroj* etj.

Formimi i fjalëve të reja bëhet me anë të parashtesave, prapashtesave ose duke bashkuar dy tema fjalësh: *përgëzoi*, *mirëkuptim*, *keqpërdorim* etj. Kjo ka qenë dhe mbetet rruga kryesore për pasurimin e gjuhës shqipe. Studimet kanë treguar se mundësitë dhe mjetet

fjalëformuese të shqipes janë të mëdha, prandaj ato duhen njohur e shfrytëzuar përherë e më shumë.

b. Rrugë apo burim i dytë për pasurimin e gjuhës shqipe është përdorimi më i gjerë i fjalëve dhe frazeologjizmave nga goja e popullit. Këto fjalë, në mjaft raste, mund të shërbejnë edhe për të zëvendësuar fjalë të huaja të panevojshme, p.sh. *gërryrje* në vend të *erosion*, *mjedis* në vend të *ambient*, *endacak* në vend të *nomad* etj.

Nga gjuha standarde eliminohet pikërisht ai element i huaj që nuk shihet si pasuri e shqipes e që është i panevojshëm, përderisa gjuha jonë ka një mjet të vetin, po aq të qartë e shprehës, i cili e zëvendëson plotësisht elementin e huaj. Natyrisht, këto mjete të shqipes ende nuk i kemi njohur plotësisht dhe duhen gjurmuar më tej, për të sjellë në gjuhën e shkrimit vlera që gjuha popullore i ka ruajtur gjatë shekujve ose që i ka krijuar dhe i krijon gjatë ripërtritjes së saj. Për këtë na bindin të gjitha hulumtimet që janë bërë gjatë shek. XX nga studiuesit shqiptarë në Shqipëri, Kosovë dhe në hapësirat e tjera shqiptare. Një dëshmi përbën edhe aksioni i organizuar për shumë vjet radhazi për mbledhjen e fjalëve dhe të shprehjeve popullore. Punë të ngjashme kanë bërë edhe në Kosovë e në trojet shqiptare në Mal të Zi e në Maqedoni. Vlen të përmenden botimet “*Fjalor fjalësh e shprehjesh popullore*”, “*Fjalorth i fjalëve të rralla*”, “*Fjalor fjalësh të rralla*” (Benedikt Dema) etj.

c. Për pasurimin e leksikut të gjuhës standarde mund të rimerren edhe fjalë të bukura që kanë qenë krijuar në epoka të mëparshme por që për arsye të ndryshme nuk kanë gjetur përdorim e kanë mbetur mënjanë. Të tilla janë, p.sh. *trimëroj* që zëvendëson fjalën e huaj *inkurajoj*, *nismë* për *iniciativë*, *miratim* në vend të *aprovim*, *kushtrim* në vend të *alarm* etj.

3. Pastrimi i gjuhës

Krahas pasurimit të gjuhës ka ecur edhe veprimtaria e pastrimit të fjalëve të huaja të panevojshme, si dhe atyre ndërtimeve sintaksore që dalin si ndikime të huaja e që nuk i shkojnë në shtat natyrës së gjuhës sonë. Pastrimit të gjuhës shqipe, ashtu edhe pasurimit të vazhdueshëm të saj, iu qasën me shumë përkushtim rilindësit tanë të mëdhenj, si: K. Kristoforidhi, Naim e Sami Frashëri, P. Vasa, J. Vreto etj. , të cilët i hynë në këtë lëmë një pune të madhe e me një metodë të re: **të nxirreshin nga gjuha letrare shqipe fjalët që ndiheshin si të huaja, - sidomos turqizmat, greqizat etj.- dhe në vend të tyre të përdorreshin fjalë të shqipes nga gjuha e gjallë popullore ose të krijoheshin fjalë të reja nga vetë burimi i shqipes.**

Kërkesa për pastrimin e gjuhës letrare buronte nga bindja shkencore e rilindasve se gjuha shqipe nuk ishte vetëm ajo që paraqitej në shkrimet e deriatëhershme dhe nuk mund të njëjtësohej as me të folmet e qyteteve, ku kishte depërtuar mënyra orientale e jetës, as me të folmet anësore, që u ishin nënshtruar ndikimeve të shumta të gjuhëve të tjera. Rilindësit ishin të bindur se gjuha shqipe ishte shumë më e pasur, më e larmishme dhe origjinale. Ata vunë re me mprehtësi se gjatë shekujve populli ynë e kishte ruajtur dhe e kishte përtërirë këtë gjuhë me dashuri e me shpirt krijues të rrallë. Ndërkaq, rilindësit e kuptonin, se shqipja, për arsye historike, kishte mbetur më pak e njohur dhe më pak e

lëvruar se disa gjuhë të tjera të Ballkanit, por ajo nuk ishte më e varfër se ato. Shqipja mund të bëhej gjuhë e një kulture të madhe. Duhet thënë se ideja dhe puna për pastërtinë e gjuhës shqipe kishte qenë shprehur edhe para Rilindjes, sidomos në veprat e autorëve të vjetër të Veriut. Ndërsa veprimtarët rilindas, duke ecur më tej, e ripërtëritën gjuhën tonë letrare dhe e vunë atë në udhë të mbarë, të cilën do ta vijonin lëvrues e mësues të shqipes në të gjitha trevat shqiptare e në diasporën arëreshe. Në kohën tonë kjo lëvizje gjuhësore është vënë në baza shkencore më të përparura, që i përgjigjen epokës së sotme. Ajo ka marrë edhe përmasa shumë më të gjera shoqërore. Dijetarët dhe gjuhëtarët shqiptarë më të shquar, si: A. Xhuvani, E. Çabej, A. Kostallari, I. Ajeti, etj. e quajnë pastrimin e gjuhës **detyrë me rëndësi të madhe**.

Edhe përpjekjet tona të sotme për pastrimin dhe pasurimin e gjuhës letrare shqipe synojnë të mos lënë të humbasin vlerat e gjuhës popullore shqipe, të ruajnë lidhjet e saj me gjuhën letrare dhe të mos lejojnë që strukturat leksiko-fjalëformuese e sintaksore të marrin karakter hibrid. Shmangia e fjalëve të huaja e bën gjuhën letrare kombëtare më homogjene e më popullore, më të qartë e më të kuptueshme. Në përpjekjet e sotme për pastrimin e gjuhës vihet re, ndryshe nga e kaluara, tehu kryesor drejtohet jo vetëm kundër turqizmeve, por edhe kundër fjalëve e ndërtimeve që kanë depërtuar e depërtojnë në gjuhën e shkruar nga gjuhët e ndryshme evropiane. Një hov mjaft shqetësues kanë marrë sidomos anglicizmat e italianizmat. Kjo lidhet me marrëdhëniet e reja që janë krijuar në shqipen e sotme në mes të leksikut të vet dhe të huajit. Shumë fjalë me burim të huaj që kanë hyrë qysh në kohët e lashta janë bërë tashmë pjesë e shqipes dhe as që mund të shtrohet çështja e luftës ndaj tyre. Po kështu, nuk mund të mos qasen në shqipen e sotme edhe fjalë e terma me karakter ndërkombëtar. Ndërkaq futja e fjalëve dhe ndërtimeve të huaja nga gjuhët evropiane, sidomos në ligjërimin libror vijon të jetë mjaft e ndjeshme. Prandaj kërkesa që shtrohet sot për ta thelluar e zgjeruar më tej veprimtarinë për pastrimin e pasurimin e gjuhës letrare dhe për ta mbrojtur shqipen nga huazimet e reja të panevojshme është plotësisht e përligjshme dhe duhet mbështetur në disa parime të përcaktuara qartë dhe të zbatueshme nga të gjithë.

3. Huazimet dhe fjalët ndërkombëtare

Në radhë të parë duhen dalluar mire ç'janë fjalë të huaja të panevojshme dhe ç'janë huazimet a ndërkombëtarizma të pranueshme. Lidhur me këtë, natyrisht, kërkohet një njohje e mirë e lëndës, maturi e qëndrime të peshuara në mënyrë që të bëhet pastrim i shoqëruar me pasurim të mirfilltë, pa cënuar aftësinë shprehëse.

Një vështrim mbi leksikun e gjuhës shqipe, jo vetëm i fondit kryesor, aktiv i fjalorit, po i mbarë leksikut të shqipes, bën të shihet e të konkretizohet mire thënia se historia e gjuhës është e lidhur ngusht me historinë e shoqërisë. Gjejmë aty, krahas fjalëve me burim amtar edhe një sasi të madhe fjalësh të huaja, të marra nga gjuhë të ndryshme, si greqishtja, latinishtja, turqishtja, gjuhët sllave, nga gjuhët neolatine. Ato janë shenja, gjurmë që kanë lënë afërsia dhe takimet e shkëmbimet e ndryshme me popujt që i kanë folur e i flasin këto gjuhë. Pra, për të njohur këtë anë të gjuhës sonë, është e nevojshme t'u kthehemi periudhave të mugëta të historisë së popullit shqiptar për të ardhur duke përjasur e shqyrtuar deri në ditët e sotme. Në vija të përgjithshme, çastet më të rëndësishme që kanë përcaktuar hyrjen e fjalëve të huaja në gjuhën shqipe kanë qenë këto:

Së pari, në periudha të hershme, fqinjësia e popullit shqiptar me grekët e vjetër e romakët. Tashmë është gjë e ditur, e argumentuar nga historianët e gjuhës, veçanërisht me studimet e Eqrem Çabejt, se “*vendi që zuri populli shqiptar në brigjet e Adriatikut caktoi edhe fatet e tij historike e bashkë me këto edhe rrugën e zhvillimit të tij*”. Ky zhvillim, për periudhën e lashtë të shqipes karakterizohet nga takimet e fqinjësisë, nga një anë, me gjuhën e kulturën e helenëve, nga ana tjetër, me sundimin e gjatë disashekullorë të romakëve. Është fjala për fqinjësi me grekët e romakët dhe për takime të gjata me **greqishten e vjetër e me latinishten**.

Së dyti, duhet kujtuar se me rënien e Perandorisë Romake, për gjuhën shqipe pati rëndësi edhe takimi me gjuhët sllave, nëpërmjet vendosjes së sllavëve në Gadishullin Ballkanik. Në kohët më të vona, në shek. XV, një process historik i jashtëm që la gjurmë në gjuhën shqipe që, padyshim, pushtimi prej osmanëve që zgjati rreth pesëqind vjet, deri në fillim të shek. XX. Pra, gjithë këto ngjarje historike kanë lënë gjurmët e tyre si në popullin shqiptar, ashtu edhe në gjuhën shqipe. Pikërisht gjurmë të tilla janë huazimet nga greqishtja, latinishtja, turqishtja, gjuhët neolatine.

Huazimet nga greqishtja . Kur flasim për këto lloj huazimesh duhet të kemi parasysh dy shtresa: njëra është më e lashtë, që lidhet me greqishten e vjetër, dhe tjetra më e vonshme që lidhet me greqishten e re. Siç dihet, takimet e gjuhës shqipe me greqishten në Ballkan kanë vazhduar në një periudhë të gjatë historike. Këto takime nisin në kohë mjaft të lashta, në periudha parahistorike dhe vijnë deri në kohët e reja, për të vijuar deri në ditët tona.

Në përgjithësi, fjalët nga greqishtja e vjetër iu përkasin fushave shoqërore, të bimësisë etj., si: *fier, qersh, pjepër, presh, mokër, lakër*. Një pjesë e madhe e huazimeve leksikore nga greqishtja u përkasin vetëm disa të folmeve jugore të shqipes, dhe, si të tilla kanë një shtrirje të kufizuar dhe do të mënjanohej nga gjuha.

Gjuhëtarët shqiptarë kanë vështuar edhe rolin dhënës të shqipes në greqishten, në të cilën kanë hyrë rreth 70 fjalë nga shqipja.

Huazimet latine . Për elementet latine të shqipes kanë rëndësi të dihen:

Së pari, që ato rrjedhin nga latinishtja popullore, e cila ishte gjuhë e folur nga populli e që dallohej nga latinishtja e shkruar.

Së dyti, për elementet latine të shqipes ka rëndësi të njihen rrethanat që ato burojnë prej asaj forme të latinishtes popullore, që quhej latinisht ballkanike d.m.th. që flitej nga popullsia e viseve të Ballkanit. Nga studimet e bëra rezultoi se ndikimi i latinishtes mbi gjuhën shqipe shtrihet kryesisht në leksik dhe jo në strukturën gramatikore të shqipes. Latinishtja ka lënë më shumë gjurmë në sfera të tilla si **pjesët e trupit**: *flokë, kokë, faqe, fytyrë, këmbë* etj.

Fjalë me origjinë nga latinishtja ka në emrat e **kafshëve shtëpiake**, si p.sh: *qen, pulë, gjel, në emrat e veglave të ndryshme*: *farkë, furkë, parmendë* etj. **emra afërsie**: *prind, ungj, fëmijë, njeri*; nga **jeta shoqërore e tregtare**: *letër, fqinj, armik, shok* etj.

Huazimet nga sllavishtja. Fjalët me burim sllav janë ato që kanë hyrë nga sebishtja, bullgarishtja gjatë kohës mesjetare. Fjalët sllave në shqip kemi në disa sfera, si: në

bujqësi, blektori, në zeytari dhe në sferën e organizimit shoqëror etj., p.sh. *trup, kockë, strehë, prag, kovaç, gozhdë, çekiç* .etj

Nga sillavishtja kanë mbetur në shqipen edhe disa emra visesh, lumenjsh, malesh etj., si: *Bistrica, Çorovoda, Pogradeci, Zadrimea* etj.

Në shek. XX kanë hyrë në shqip edhe disa fjalë nga rusishtja, të cilat në pjesën më të madhe kanë karakter ndërkombëtar, si : *kulak, bolshevik, sovjetik* etj.

Huazimet nga turqishtja. Futja e fjalëve turke në gjuhën shqipe ka nisur që në shek. XV dhe ka vijuar më tej më se pesë shekuj të pushtimit osman. Fjalët e huaja që kanë hyrë në shqipen gjatë kësaj periudhe të gjatë kohe, kanë prekur më tepër jetën qytetare, veshjet, kuzhinën, administratën, kurse ndikimi në fushat e tjera, si bujqësia, blektoria, bimësia ka qenë më i pakët.

Më të hershmet kanë qenë huazimet që u përkasin veshjeve dhe luftës, si: *bori, daulle, dyfek, çorape, fitil*, po edhe të fushave të tjera, si: *penxhere, hambar, sahat, pazar, manushaqe, raki, tepsi* etj. Shumë fjalë të burimit turk janë përvetësuar plotësisht nga shqipja dhe janë bërë me kohë pjesë e pamënjanueshme e saj, si: *baba, xhep, kafe, top* etj. Nga turqishtja kanë hyrë edhe disa prapashtesa si: **-xhi, -çi, -llëk** etj., të cilat më vonë në shqipen u janë shtuar edhe temave të tjera, si: *furrëxhi, sahatçi, bejlerë* etj.

Duhet të vëmë re disa veçori të huazimeve nga turqishtja:

- a) Shumë fjalë të burimit turk, duke qenë se u përkasin sferave të lëvizshme kanë qenë të paqëndrueshme dhe kjo ka bërë që të dalin shumë fjalë turke nga përdorimi, të cilat janë zëvendësuar e po zëvendësohen me fjalë shqipe si: *penxhere, aksham, sabah* etj. Kanë dalë nga përdorimi fjalët turke që lidheshin me organizimin feudal, si: *kajmekan, vali, xhelep, vilajet* etj.
- b) Një numër i madh fjalësh me burim nga turqishtja sot kanë marrë ngjyrim emocional stilistik për hir të të cilit ato vazhdojnë që të përdoren në ligjërimin e folur dhe në letërsinë artistike, si p.sh. *dembel, matrapaz, pazarllëk, baballëk* etj.
- c) Pjesa dërrmuese e fjalëve me burim nga turqishtja nuk janë tema prodhuese për formimin e fjalëve të reja, gjë që tregon për paqëndrueshmërinë e tyre.
- d) Disa turqizma kanë ngelur në gjuhën shqipe vetëm në shprehje të ngurosurave dhe nuk përdoren jashtë tyre si fjalë të mëvetësishme, si p.sh. *bëj derman, bëj helaq, s'bëhem kabull* etj.
- e) Shumë fjalë me burim nga turqishtja përdoret vetëm në disa të folme të veçuara dhe nuk hynë në leksikun e gjuhës letrare. Të tilla janë: *selamet, baft, nafakë* etj.

Huazimet nga gjuhët romane. Pas mbarimit të pushtimit romak shqipja vijoi të ketë ndikime nga gjuhët romane, bija të latinishtes, sidomos nga italishtja dhe frëngjishtja.

Nga italishtja kanë hyrë shumë fjalë në sferën e tregtisë, të lundrimit, të luftës etj. p.sh: *bankë, karrocë, barkë, vapor* etj. Fjalë si këto kishin hyrë nga italishtja në kohën e mesme ndërsa pas vitit 1912 e deri më 1939 u shtua numri i fjalëve me burim italian, duke prekur edhe sferat e bujqësisë, të mobilerisë, të kuzhinës, të modës, të artit etj. Shumë prej tyre nuk ishin huazime të nevojshme, prandaj me kohë janë mënjanuar e po dalin jashtë përdorimit, duke ua lënë vendin fjalëve shqipe përkatëse që kishin qenë në gjuhë ose që janë krijuar me mjetet e brumit e saj.

Nga frëngjishtja në gjuhën shqipe kanë hyrë që nga fundi i shekullit të kaluar e në fillim të këtij shekulli. Ato kanë gjetur përdorim në administratë, në drejtësi, në shkollë, në jetën shoqërore e politike, në sport, modë etj. Të tilla janë: *dosje, byro, adresë, shofer, kamion, grevë, triko, pallto, perdesy* etj.

4. Qëndrimi ndaj fjalëve me burim të huaj

Për të mbajtur një qëndrim të drejtë ndaj fjalëve me burim të huaj kërkohet në radhë të parë njohje e mirë e shtresimit të tyre, e vendit të ato kanë zënë në gjuhë, e vlerave kuptimore dhe stilistike që kanë pasur në gjuhën prej nga janë marrë dhe të atyre kuptimeve të reja që mund të kenë fituar pasi janë bërë pronë e shqipes. Duhet të dimë gjithashtu përhapjen apo shtrirjen hapësinore të tyre. Me fjalë të tjera, duhet bërë një vështrim historik, nëpërmjet të cilit mund të nxjerrim si përfundim se qëndrimi ndaj fjalëve me burim të huaj nuk mund të jetë i njëjtë.

Huazimet nga gjuhët e huaja, ndryshe nga fjalët e huaja të panevojshme e të parrënjosura në gjuhë, e kanë gjetur tashmë vendin e tyre në gjuhë. Mbi këtë bazë mund të dallojmë:

a) Fjalë me burim të huaj që janë përvetësuar nga shqipja, që janë bërë pjesë e leksikut të shqipes. Hyjnë këtu huazimet e vjetra si: *qytet, faqe, mjeshtër, i pastër, këndoj* dhe fjalët ndërkombëtare: *analizë, aritmetikë, histori, filologji, ideologji, klasë* etj.

Si fjalë ndërkombëtare vështrohen ato fjalë që përdoren në shumicën e gjuhëve të botës.

b) Me burim të huaj, të cilat me kohë kanë dalë nga përdorimi i gjerë, për shkak se janë zhdukur vetë sendet a nocionet që shprehin ato si: *xhandar, breshanë* etj.; ose janë zëvendësuar me fjalë shqipe.

c) Fjalë të huaja të panevojshme, të cilat janë zëvendësuar e po zëvendësohen me fjalët shqipe ekzistuese ose të krijuara me brumin e shqipes sipas gjerdheve të gjuhëve të tjera si: *fundjavë, fundvit* etj.

Duhet bërë përpjekje për të zëvendësuar ose për t'ua ngushtuar më tej përdorimin një numri fjalësh të leksikut të përgjithshëm me burim nga gjuhët sllave, nga greqishtja e turqishtja.

Kundër fjalëve të tilla të huaja të panevojshme është drejtuar sot lufta e puna e “Komisionit të përhershëm për pastrimin e pasurimin e gjuhës shqipe”, nën drejtimin e të cilit, prej disa kohësh, ka nisur të botohet tek revista “*Gjuha jonë*” rubrika “Fjala shqipe në vend të fjalës së huaj”.